# DËSHMI ARKIVI

**A-436868**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 88 nxënës fitues të olimpiadave vlerësohen në Kryeministri, Rama: Jeni frymëzim! Mos u dorëzoni dhe mos e tradhtoni kurrë ëndrrën që keni |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/88-nxenes-fitues-te-olimpiadave-vleresohen-ne-kryeministri-rama-jeni-fry-i585415` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 13:28:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 13:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 060bfe8b620e07d829330b05456f5f65ee1f25d3f197746462d2068c7417030e |
| TEKSTI | 582db4869a71d61ebc6b4f97dfeb7b01b04953f91e439413f9e3c152e53a9a66 |
| PAMJA | 233bfd8d075bc13ebd388add4b9197c67ba87a997c36a542e2d66df677766841 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | f3e7c630805d32d32de333ffd39c7bbc1a76faffe019f04faa761b735a9c99e0 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f3e7c630805d32d32de333ffd39c7bbc1a76faffe019f04faa761b735a9c99e0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# 88 nxënës fitues të olimpiadave vlerësohen në Kryeministri, Rama: Jeni frymëzim! Mos u dorëzoni dhe mos e tradhtoni kurrë ëndrrën që keni

11 Shtator 2026, 15:35Sociale TEMA

88 nxënës fitues të olimpiadave vlerësohen në

Kryeministri Edi Rama mikpriti sot në mjediset e Kryeministrisë, nxënësit fitues të Olimpiadave Kombëtare dhe Ndërkombëtare në Matematikë, Biologji, Kimi, Gjuhë, Letërsi dhe fusha të tjera të dijes.

"Kini besim të palëkundur te vetja dhe mbi të gjitha, besojini symbyllur ëndrrës që shikoni me sy hapur." – inkurajoi Kryeministri Rama teksa shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin për nxënësit, duke theksuar se suksesi i tyre është dëshmi e potencialit të të rinjve shqiptarë, por edhe e një pune të gjatë për përmirësimin e sistemit arsimor.

"Takimi vjen sot pak ditë pasi kemi marrë një lajm që personalisht më ka pëlqyer shumë. Ndjen vërtetë kënaqësi, testi PISA 2025, që për mua personalisht është një fryt shumë I shijshëm I një pune shumë të gjatë jo të lehtë me të përpjeta dhe tatëpjeta për të transformuar sistemin tonë arsimor, përmbajtjen e mësimit në shkollë, duke transformuar cilësinë e teksteve, situatën e mësuesve që gjithmonë meritojnë më shumë, por këtë punë të gjatë na u desh ta nisëm nga qetësia e tyre psikologjike që të jenë në vendin e punës për meritë dhe mos lëvizin për arsye që nuk lindin me profesionin me meritën. Për të krijuar kushtet që të vijojnë një process trajnimesh si edhe për të rritur cilësinë e drejtimit të shkollave. Drejtuesit e shkollave shkojnë mësojnë certifikohen dhe kthehen në punë me dije të reja. Dhë ne fund për të krijuar një atmosferë më pozitive në shkolla.

Nxënësit mund të jenë shumë të mirë, por nëse gjithçka rreth e rrotull tyre nuk ua bën më të lehtë përpjekjen, atëherë rezultatet nuk mund të jenë domosdoshmërisht ato që japin. Që t'u them se si u krijua kjo mundësi për t'u takuar së bashku, e vërteta është që nisi nga një nxënës që u bë i famshëm në mjedisin shqiptar për shkak të një rezultati në një olimpiadë botërore të matematikës. Ministrja më tha që nuk është vetëm ky djali, por ka edhe shumë të tjerë. Kjo është fantastike dhe është tregues i rëndësishëm, i rritjes në përgjithësi të nivelit të nxënies, sepse është rritur edhe niveli i mësimdhënies. Jam i bindur që edhe mes jush ka fëmijë të cilët kanë probleme në familje. Ndër fëmijët e Shqipërisë ka të tillë, që dëshpërohen, ose që mjaftohen me ato justifikime dhe nuk bëjnë përpjekje për t'i kapërcyer ato vështirësi. Prandaj ju jeni shembulli se si Shqipëria e gjitha duhet të mendojë, që pavarësisht vështirësive dhe prapambetjes, të guxojë, të synojë që të nxitet sa më lart dhe sa më shpejt. Forca e shembullit tuaj është heroike në kuptimin e plotë të fjalës.

Të jesh hero do të thotë që të kapërcesh të gjitha pengesat që të tjerët në të njëjtat kushte nuk do të guxonin. Unë e di që ju mbase keni edhe problemin tjetër, që jeni shumë të mirë për të qenë idhulli i klasës. Sa më shumë të bëni sukses, aq më shumë do të jenë zërat që do ju thonë se suksesi juaj nuk është i vërtetë, apo i merituar. Siç thoshte dhe Faik Konica që ne jemi shumë të mirë dhe falim çdo gjë, por nuk falim suksesin. Për mua personalisht ju jeni frymëzim, sepse në punën që unë bëj, kam nevojë të frymëzohem nga shembuj njerëzish që nuk janë në kushte ideale për të bërë sukses, por bëjnë sukses. Për mua ky është inspirim. Kur e bëni ju, atëherë unë patjetër që do ta bëj." tha Rama.

Në përfundim të takimit, nxënësit fitues u pajisën me certifikata dhe morën dhurata simbolike në shenjë mirënjohjeje për rezultatet dhe përfaqësimin e denjë të Shqipërisë në olimpiadat kombëtare dhe ndërkombëtare.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Vlerësohen 88 olimpiadistë, Kumbaro: Ju jeni prova që s’mund të vareni nga teknologjia, por ta keni në duart tuaja për të zhvilluar mendimin kritik]

14:59 Sociale

[Rregullorja censuruese e GJKKO-së shkon në Kushtetuese, gazetarët padi të hënën: Të pezullohet deri në marrjen e një vendimi]

14:12 Sociale

[Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro në 46 mjete të reja për operimet në pistë]

13:45 Sociale / 1 koment

[“Fond kombëtar për strehimin” - Ibrahimaj: 7 mijë apartamente për shtresat në nevojë. Subvencionim qiraje për 3 mijë banesa]

11:20 Sociale

[“Na kanë përmbytur tre herë” - Banorët e ish-Kënetës në protestë, bllokojnë dhe rrugën: Kërkojmë investime dhe pastrim të kanaleve!]

08:55 Sociale / 15 komente

[Nga sot Check-up kalon në shtet pa kufi të sipërm moshor/Rritja e numrit të përfituesve do të menaxhohet me të njëjtat s]

21:55 Sociale / 6 komente

[Ministri Salla: Të rinjtë të zgjedhin arsimin profesional dhe bujqësinë]

20:25 Sociale / 4 komente

[“Më shkruan në 1-2 të natës”/ Dashnor Sula rrëfen komunikimin me Ramën: Më dërgon problemet e qytetarëve dhe kërkon përgjigje]

19:45 Sociale / 14 komente

[Në prag të vitit të ri shkollor, Bashkia e Tiranës masa të shtuara për institucionet arsimore! Në fokus garantimi i procesit të rregullt mësimor]

18:15 Sociale

[Fermeri shqiptar prodhon speca të kuq me helme, Kroacia gropos 14.7 tonë]

17:35 Sociale / 9 komente

**Më të lexuarat**

**24 orët e fundit**

24 orët e fundit

**Javen e fundit**

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 21 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 30 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “aferën e armëve” m...**

15:30 Dossier / 13 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve**

13:50 Blog / 9 komente

**Ministrja që Rama po kërkon**

12:40 Blog / 12 komente

**Demokracia, jo më si vlerë lirie**

12:30 Blog / 5 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.